Aktualitet

EMRI/ Të armatosur me kallashnikovë dhe me shkopinj në duar, 4 persona futen në lokal dhe rrahin të riun në Fushë-Krujë! Disa të shoqëruar

I riu i cili ka rënë pre e dhunës, quhet Elvis Elezi, banor i lagjes ku ka ndodhur ngjarja. Një vit me parë ka qenë pre e një sulmi me lëndë plasëse, pasi një sasi eksplozivi ju hodh në banesë, por fatmirësisht nuk shkaktoi të lënduar por vetëm dëme materiale


Elvis Elezi

Redaksia
19 Shkurt, 11:03 | Përditesimi i fundit: 19 Shkurt, 13:08

FUSHË-KRUJË: 4 persona me maska dhe të armatosur me kallashnikov, pistoletë dhe më shkopinj kanë hyrë dy netë më parë në një lokal në lagjen e 'Bakushe Visha' të Fushë-Krujës.

Report Tv raporton se në 4 personat e maskuar, kanë zbritur nga një makinë dhe janë futur në një lokal, dhe nën kërcënimin e armës i kanë bërë thirrje klientëve të mos lëvizin.

LEXO EDHE:

Pa maska, të përqafuar dhe mbi 30 veta në një ambient të vogël, Paloka 'harron' pandeminë, mbledh anëtarët e shtabit Fushë Krujë në thyerje të masave antiCOVID

Më pas ato kanë tërhequr një të riun, të cilin fillojnë ta godasin me dhunë ç'njerëzore me një shkop e me mjete te tjera.

I riu i cili ka rënë pre e dhunës, quhet Elvis Elezi, banor i lagjes ku ka ndodhur ngjarja. Një vit me parë ka qenë pre e një sulmi me lëndë plasëse, pasi një sasi eksplozivi iu hodh në banesë, por fatmirësisht nuk shkaktoi të lënduar, por vetëm dëme materiale.

I dhunuari ka qenë arrestuar vite më parë për trafik droge në Kroaci, por ka disa vjet që ka dalë nga burgu. Aktualisht është i papunë dhe është prind i një fëmije të vogël. Policia e Durrësit nga varet dhe komisariati i Policisë Krujë, të cilët kanë reaguar për ngjarjen pas 3 ditësh.

> *"Në lidhje me disa pamje filmike të publikuara në media, ku shfaqen disa persona duke dhunuar një shtetas në një lokal, ju sqarojmë se: Më datë 17.02.2021, në orën 19:40, në ambientin e një lokali në Fushë Krujë, kanë hyrë disa persona ende të paidentifikuar (dyshohet të armatosur), të cilët kanë goditur me sende të forta, duke i shkaktuar lëndime në kokë shtetasit E. E., 30 vjeç, banues në Fushë Krujë, i cili pasi ka marrë ndihmën mjekësore, është larguar në banesën e tij.*
>
> *Menjëherë pas kallëzimit të bërë nga shtetasi E. E. është ngritur një grup i posaçëm hetimor i përbërë nga specialistë për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Krujë dhe specialistë për Hetimin e Krimeve në DVP Durrës, të cilët kanë bërë shqetësimin e disa shtetasve të dyshuar dhe në cilësinë e provës materiale janë administruar disa pamje filmike. Nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë vijojnë punën intensive hetimore për identifikimin dhe kapjen e autorëve të kësaj ngjarjeje", thuhet në njoftimin e policisë të pas 3 ditëve.*

Natën e ngjarjes disa furgonë policia kanë ardhur nga Durrësi dhe kanë kryer disa kontrolle, por deri tani asnjë i ndaluar për ngjarjen e rëndë.


Pjese nga dhuna

M.Q./r.k./Shqiptarja.com
TAG: fushe kruje | Dhune | policia e krujes | Elvis Elezi

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
DASH vlerëson gjyqtarin Dvorani për luftën ndaj korrupsionit! Si e vlerësoni këtë zhvillim?

Pozitiv | Negativ | Nuk kam mendim

Komento

Komente

Loni: 19/02/2021 20:21
Qe te hymns ashtu e te rrezikojne 4 maskara o ja ka ber borxh ose kan ngaterruar person si perhere...
Përgjigju

Lajme të tjera

Aktualitet


Plagosën me armë zjarri nënë e bir pas sherrit për një vend parkimi, policia arreston edhe vëllanë e autorit, ishte pjesë e sherrit
23 Shkurt, 22:37

Aktualitet


'Gjobë kush fut në lokal politikanë për fushatë', shoqata e biznesit-Ramës: Si t'i dallojmë bindjet e atyre që hynë e dalin? Boll me kërcënime diktatoriale
23 Shkurt, 22:35

Aktualitet


Pandemia 'step' zgjerimin e familjeve! Lindjet zbresin në nivelin më të ulët që prej '90! Në 2020 erdhën në jetë 28 mijë bebe! Vetëm 3 qarqe në rritje
Eliza Gjediku
23 Shkurt, 22:20

Aktualitet


Dëmtime kabulli, këto zona në Tiranë pa energji elektrike
23 Shkurt, 20:53

Aktualitet


U zunë për një vend parkimi, plagosin me armë zjarri nënë e bir në Durrës, arrestohen dy vëllezërit
23 Shkurt, 20:19

Aktualitet


Rama: Nuk është Game of Thrones, por Kalaja e Beratit
23 Shkurt, 20:01

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

MINUTË PAS MINUTE

23:06 Digjet një makinë e parkuar në Elbasan, merr fjalë dhe mjeti ngjitur me të! Zjarri dyshohet i qëllimshëm

23:05 Alimehmeti: Një studim thotë se kush e ka kaluar COVID në 6 muajt e fundit s'do vaksinohet! Ai që del pozitiv pas dozës së parë s'bën të dytën

23:02 Rritja e shifrave me COVID, mjekët në 'Repolitix': Situata tepër kritike, jemi si në periudhën e Italisë në marsin e kaluar

22:37 Plagosën me armë zjarri nënë e bir pas sherrit për një vend parkimi, policia arreston edhe vëllanë e autorit, ishte pjesë e sherrit

22:38 'Gjobë kush fut në lokal politikanë për fushatë', shoqata e biznesit-Ramës: Si t'i dallojmë bindjet e atyre që hynë e dalin? Boll me kërcënime diktatoriale



MOTI

Shqipëri

Qytetet	Mëngjes	Drekë	Pasdite
Tirana	6.59°C	10.98°C	11.29°C
Korce	6.05°C	4.91°C	5.26°C
Shkoder	8.21°C	11.01°C	11.7°C
Gjirokaster	9.20°C	10.42°C	10.52°C

Me të lexuarat e ditës | Me të lexuarat e javes
Lajme | Fotogaleri | Videogaleri

© 2011 - 2021 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje